



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2813/5 prot.

Tiranë, më 26.12.2025

REKOMANDIM

Nr. 57, datë 26.12.2025

PËR KONTROLLUESIN “LUX TAXI” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Lux Taxi” sh.p.k (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 234, datë 30.10.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nipt M01321025V dhe ushtron aktivitetin si shërbim taksi brenda dhe jashtë territorit të vendit, blerje shitje makina, dhënie makina me qera. Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “klientë”, “punëmarrës”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka krijuar në platformën “Instagram”, profil zyrtar, në të cilin pasqyron veprimtari të ndryshme, duke ilustruar nëpërmjet fotografive dhe videove, të dhënat e subjekteve, punonjës, pjesëmarrës, etj.

Konstatohet se, të dhënat personale të subjekteve janë përpunuar dhe/ose publikuar në rrjetin social “Instagram”, pa marrë paraprakisht pëlqimin e tyre, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe me kriteret për përpunimin e tyre, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe në mungesë të pëlqimit të kërkuar, sipas nenit 8 të po këtij Ligji.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive të subjekteve të të dhënave në platforma si “Instagram”, pa marrë paraprakisht “Pëlqimin”, bie në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Ligjit.

“Pëlqim” është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklarate ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike.

3. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, për qëllim të sigurisë së nëpunësve dhe aseteve. Mbikëqyrja e ambientit të jashtëm të Kontrolluesit, përveç derës së jashtme të zyrave, përfshin edhe ambiente të tjera si sheshe të pallateve dhe rrugëve, me mundësi fokusimi edhe të qytetarëve.

Ky konstatim është në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 7 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Gjithashtu, Kontrolluesi nuk disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri në kundërshtim me parashikimin e nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i survejimit audio/video (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “video”, “imazhe” dhe “zëri/audio”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, mbikëqyrja e ambienteve të jashtme të Kontrolluesit, nëpërmjet sistemit të video/audio survejimit, është në kundërshtim me parashikimet e neneve 6 dhe 7 të Ligjit. Gjithashtu, në zbatim të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-surveimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit, të miratuar nga Komisioneri.

4. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka të publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://taxiluxalbania.al>. Subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrimin që të publikojë “*Politikën e Privatësisë*” dhe të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

5. Kontrolluesi nuk disponon “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*” (në vijim, “*Vendimi nr. 6*”)

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregulloreje “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” përbën një detyrim thelbësor ligjor për çdo kontrollues, në zbatim të nenit 28 të Ligjit. Kjo rregullore duhet të përmbajë në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin

e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të kontrolluesit.

6. Kontrolluesi nuk ka marrë masa teknike dhe organizative të përshtatshme, për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Për sa më sipër, rezulton mos përmbushje e detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47, të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO 27001:2022, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre” (në vijim, “Udhëzimi nr. 48”) i cili është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

7. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit e tij, “Deklaratën e Konfidencialitetit”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 30 i Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, qëllimi i nënshkrimit të “Deklaratës së Konfidencialitetit” është që të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë, detyrimet dhe përgjegjësitë që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

8. Konstatohet se, aktivitetet kryesore të Kontrolluesit janë procese përpunimi, të cilat, për shkak të natyrës, fushës së zbatimit ose qëllimeve të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt e sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë. Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese, që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në rastin e caktimit të një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 12.12.2025, gjatë të cilës ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, përfaqësuesi i Kontrolluesit gjatë seancës dëgjimore ka depozituar dokumentacion si më poshtë vijon:

- Fotografit të tabelës sipas standardit të Udhëzimit nr. 3, të Komisionerit;
- Formularët tip të pëlqimit për punonjës dhe klientë.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 8, 13, 28, 33, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje marrjen e “Pëlqimit” të subjekteve të të dhënave në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit;

2. Kontrolluesi të marrë masa për përcaktimin e planeve të kamerave përmes sistemit të video-surveimit (CCTV), si dhe të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat “video/audio” të mbledhura për subjektet e të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;
3. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përditësimin e rubrikës “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://taxiluxalbania.al>, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave për të gjitha proceset përpunuese, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e “*Rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale*”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, përcaktimin e niveleve të aksesit etj.;
6. Kontrolluesi, të marrë masa lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre, sipas parashikimeve të përcaktuara në gërmat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 34 të Ligjit;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;¹
8. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;²
9. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - i. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 3 më sipër;
 - ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 4 më sipër;
 - iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 më sipër;
 - iv. brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

10. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
11. Në rast mospërbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, të pikës 2, të nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me Ligjin. Në rast të mos zbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 26.12.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

¹ Udhëzimi nr. 47 dhe Udhëzimi nr. 48 janë shfuqizuar me Udhëzimin nr. 08, datë 20.11.2025 “Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues”.

² Detyrimet e parashikura në Udhëzimin nr. 47 dhe nenin 5 të udhëzimit nr.48, vijojnë sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 9, datë 20.11.2025 “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale”.